



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3521/7 prot.

Datë 13.01.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 56/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 13.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur- Pune Publike”, me Nr. REF-66960-10-28-2025, me objekt: “Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”,Rruga Pavarësia”, me fond limit: 15 310 675.13 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë presje trembëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe adresë Lagjja Kastrioti ,rruga Andon Profka ,2 kullat Fier.

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Lushnje me adresë Lagja “Kongresi “ Lushnjë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

##### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

#### **II**

##### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur- Pune Publike”, me Nr. REF-66960-10-28-2025, me objekt: “Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”,Rruga Pavarësia”, me fond limit: 15 310 675.13 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë presje trembëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

II.2. Në datën 14.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 19.11.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

|                                                                |               |                |
|----------------------------------------------------------------|---------------|----------------|
| 1. “Shendelli” shpk                                            | 11 075 074.5  | I kualifikuar  |
| 2. “MODESTE” shpk                                              | 11 826 203    | I kualifikuar  |
| 3. BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk<br>& “T&J Construction” shpk | 12 068 166,60 | I skualifikuar |
| 4. “LEON KONSTRUKSION” shpk                                    | 13 319 289.38 | I kualifikuar  |
| 5. “SARK” shpk                                                 | 13 773 398    | I kualifikuar  |

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik autoriteti kontraktor në rubrikën “Kërkesa” me datë 20.11.2025 i ka kërkuar operatorit ekonomik “Shendelli” shpk në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor me datë 27.11.2024 sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik i ndryshuar” me përmbajtje si vijon; “Duke iu referuar procedurës së prokurimit me objekt: “**Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”, Rruga Pavarësia**” REF-66960-10-28-2025, informojmë Operatorin Ekonomik “Shendelli” SH.P.K., se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: 11,075,074.5 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër pikë pesë) lekë pa TVSH, është klasifikuar si oferta e renditur në vendin e parë në klasifikimin perfundimtar.

Në zbatim të pikës 5, të nenit 82, të ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 6 ku përcaktohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një document të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë, me adresë: Lagja Kongresi, Lushnjë**, dokumentet provuese, si edhe dokumentet e tjera shoqëruese, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi”

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 27.11.2025, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke i njoftuar operatorët ekonomikë me

anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

|                                                                |               |                |
|----------------------------------------------------------------|---------------|----------------|
| 1. “Shendelli” shpk                                            | 11 075 074.5  | I skualifikuar |
| 2. “MODESTE” shpk                                              | 11 826 203    | I kualifikuar  |
| 3. BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk<br>& “T&J Construction” shpk | 12 068 166,60 | I skualifikuar |
| 4. “LEON KONSTRUKSION” shpk                                    | 13 319 289.38 | I kualifikuar  |
| 5. “SARK” shpk                                                 | 13 773 398    | I kualifikuar  |

II.6. Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumenteve të tjera shoqërues të ofertës, bazuar në nenin 82, të LPP-së dhe nenin 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konstatoi mangësi dhe parregullsi, si më poshtë: Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup>”. Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup> në pronësi. Gjithashtu në të dhënat e tjera ka deklaruar se kjo vërtetohet me Faturën tatimore të blerjes me nr 528 dt 22.07.2024. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup> pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK, sikurse është deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Rrul kompresor me vibrim”. Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Rrul kompresor me vibrim në pronësi. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Rrul kompresor me vibrim, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese ) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK, sikurse është deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Për sa më sipër, nuk provohet përmbushja e kriterëve për kualifikim. Mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK skualifikohet”.

II.7. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 04.12.2025 është publikuar “Njoftimi i Fituesit Paraprak” të procedurës së mësipërme të prokurimit, publikuar edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 78, datë 09.12.2025, ku është shpallur fitues OE “Modeste” shpk.

II.8. Në datën 09.12.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3521/2025 protokolli, datë 09.12.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/6158 e OE “Shendelli” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.9. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3521/1 prot., datë 10.12.2025.

II.10. Nëpërmjet sistemit elektronik, autoriteti kontraktor me shkresën me datë 12.12.2025, protokolluar me tonen me nr.3521/2 prot., datë 12.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, me datë 12.12.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar “[...]”: *“Në ankesën e paraqitur operatori ekonomik “Shendelli” shpk ka pretenduar se mund të mos jetë dorëzuar dokumentacioni provues për disponimin e mjetit Rrul kompresor me vibrim dhe mjetit Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m3, por me deklarimin e disponimit të mjeteve në Formularin e vetëdeklarimit, kriteret e veçanta për kualifikim automatikisht janë plotësuar. Për sa i përket këtij pretendimi ju bejme me dije se: Sipas nenit 26 të “Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet se : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”. Pra ky formular është një instrument ligjor që zëvendëson dokumentet provuese në fazën e ofertimit dhe paraqet një garanci paraprake për autoritetin kontraktor. AK Bashkia Lushnjë ndoqi hapat proceduriale Bazuar në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet shprehimisht se: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të*

këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike” dhe në datën 19.11.2025 ka nisur shkresën me Nr 10355 Prot me objekt: Kërkesë për dorëzim dokumentacioni. Në datën 25.11.2025 është paraqitur pranë AK Bashkia Lushnjë shkresa përcjellëse me objekt: Dorëzim dokumentacioni. Përmbajtja e kësaj shkrese konsiston në: Dokumentet e sipërmarrësit “Shendelli” shpk, dokumentet ligjore, financiare, teknike, të noterizuara për objektin e lartëpërmendur, të grupuara sipas Nr: Nr.6532 Rep. datë 20.11.2025 Fq 1-165 Fq Nr.6530 Rep. datë 20.11.2025 Fq 1-166 Fq Nr.6529 Rep. datë 20.11.2025 Fq 1-212 Fq Nr.6531 Rep. datë 20.11.2025 Fq 1-132 Fq.

Nga kontrolli i detajuar i dokumentacionit provues paraqitur nga Operatori Ekonomik “Shëndelli” Shpk, nga anëtarët e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Rrul kompresor me vibrim dhe mjetit Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m3, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse ) për të provuar se këto mjete disponohen dhe janë në pronësi të operatorit ekonomik “Shendelli” Shpk. Operatori Ekonomik me mosparaqitjen e këtyre dokumenteve provuese nuk plotëson kërkesën për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim, ku përcaktohet shprehimisht se operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi apo me qira minimumi Rrul kompresor me vibrim (1 copë) dhe Eskavator me Zinxhir (1 copë) min. 0,25 m3. OE “Shendelli” shpk edhe pse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në fazën e dorëzimit të ofertave ka deklaruar, se disponon 1 copë Rrul kompresor me vibrim dhe 1 copë Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m3, në momentin procedural, të dorëzimit të dokumentacionit origjinal për verifikim nga ana e autoritetit kontraktor para shpalljes së tij fitues, nuk ka dorëzuar dokumentacion provues për këto mjete, të cilat në shkronjën “i” të Nenit 26 pika 2 dhe 6 janë parashikuar shprehimisht që duhet të dorëzohen me dokumentacion provues në origjinal ose të njësuara me origjinalin”.

Në rastin konkret, gjykohet se dokumentacioni i paraqitur nga OE “Shendelli” shpk nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”,Rruga Pavarësia.

Në përfundim Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

VENDOSI:

Të mos e pranojë ankesën e paraqitur nga Operatorit Ekonomik “Shendelli” shpk”.

II.11. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 10992 prot., datë 12.12.2025, protokolluar me tonen me nr.3521/3 prot., datë 15.12.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe dokumentacionin fizik të operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK.

II.12. Me shkresën me nr. 326 prot., datë 09.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3521/4 prot., datë 12.01.2026, autoriteti kontraktor, ka paraqitur një kërkesë për informacion.

II.13. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2. Në datën 14.11.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 19.11.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

|                                   |               |                |
|-----------------------------------|---------------|----------------|
| 1. “Shendelli” shpk               | 11 075 074.5  | I kualifikuar  |
| 2. “MODESTE” shpk                 | 11 826 203    | I kualifikuar  |
| 3. BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk |               |                |
| & “T&J Construction” shpk         | 12 068 166,60 | I skualifikuar |
| 4. “LEON KONSTRUKSION” shpk       | 13 319 289.38 | I kualifikuar  |
| 5. “SARK” shpk                    | 13 773 398    | I kualifikuar  |

III.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik autoriteti kontraktor në rubrikën “Kërkesa” me datë 20.11.2025 i ka kërkuar operatorit ekonomik “Shendelli” shpk në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor me datë 27.11.2024 sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik i ndryshuar” me përmbajtje si vijon; “Duke iu referuar procedurës së prokurimit me objekt: “ **Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”,Rruga Pavarësia ” REF-66960-10-28-2025, informojmë Operatorin Ekonomik “Shendelli” SH.P.K., se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: 11,075,074.5 (njëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër pikë pesë) lekë pa TVSH, është klasifikuar si oferta e renditur në vendin e parë në klasifikimin perfundimtar.**

Në zbatim të pikës 5, të nenit 82, të ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM-së 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 6 ku përcaktohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve

të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një document të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur”. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë, me adresë: Lagja Kongresi, Lushnjë**, dokumentet provuese, si edhe dokumentet e tjera shoqëruese, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi”

III.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimes rezulton, se në datën 27.11.2025, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke i njoftuar operatorët ekonomikë me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

|                                                                |               |                |
|----------------------------------------------------------------|---------------|----------------|
| 6. “Shendelli” shpk                                            | 11 075 074.5  | I skualifikuar |
| 7. “MODESTE” shpk                                              | 11 826 203    | I kualifikuar  |
| 8. BOE “ISOBAR CONSTRUCTION” shpk<br>& “T&J Construction” shpk | 12 068 166,60 | I skualifikuar |
| 9. “LEON KONSTRUKSION” shpk                                    | 13 319 289.38 | I kualifikuar  |
| 10. “SARK” shpk                                                | 13 773 398    | I kualifikuar  |

III.6. Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin provues të vetëdeklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe të dokumenteve të tjera shoqërues të ofertës, bazuar në nenin 82, të LPP-së dhe nenin 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konstatoi mangësi dhe parregullsi, si më poshtë: Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup>”. Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup> në pronësi. Gjithashtu në të dhënat e tjera ka deklaruar se kjo vërtetohet me Faturën tatimore të blerjes me nr 528 dt 22.07.2024. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Eskavator me zinxhir min 0.25 m<sup>3</sup> pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK, sikurse është deklaruar në Formularin

e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Në formularin e vetëdeklarimit ngarkuar në SPE, si edhe pjesë e dokumentacionit provues dorëzuar pranë AK, për plotësimin e pikës 2.7 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme.... 1(një) Rrul kompresor me vibrim”. Operatori ekonomik ka vetëdeklaruar se e disponon mjetin Rrul kompresor me vibrim në pronësi. Si dokumentacion provues për përmbushjen e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumentacionit provues të dorëzuar fizikisht pranë AK, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Rrul kompresor me vibrim, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese ) për të provuar se ky mjet disponohet dhe është në pronësi të operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK, sikurse është deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Për sa më sipër, nuk provohet përmbushja e kriterëve për kualifikim. Mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik “SHENDELLI” SHPK skualifikohet”.

III.7. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 04.12.2025 është publikuar “Njoftimi i Fituesit Paraprak” të procedurës së mësipërme të prokurimit, publikuar edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike me nr. 78, datë 09.12.2025, ku është shpallur fitues OE “Modeste” shpk.

III.8. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.8.1. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.8.2. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet

*të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”*

III.8.3. Në nenin 32, pika 1 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimin e fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike”.

III.8.4. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Nga kontrolli i detajuar i dokumentacionit provues paraqitur nga Operatori Ekonomik “Shëndelli” Shpk, nga anëtarët e Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk provohet disponueshmëria e mjetit Rrul kompresor me vibrim dhe mjetit Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m3, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse ) për të provuar se këto mjete disponohen dhe janë në pronësi të operatorit ekonomik “Shëndelli” Shpk”, pretendimet e këtij të fundit, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se afatet e kryerjes së veprimeve procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet shprehet sipas rastit në ditë, muaj apo vite. Akti nënligjor për rregullat e prokurimit publik, konkretisht VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, afatin e publikimit të njoftimit të fituesit për një procedurë prokurimi e ka llogaritur në ditë dhe konkretisht duke i vendosur një afat maksimal jo më vonë se 7 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave. Nga ana tjetër referuar bazës ligjore të sipërcituar në rastet e procedurave të prokurimit me operatorë ekonomikë të kualifikuar si oferta të suksesshme, autoriteti /enti kontraktor ka detyrimin ligjor që përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike sipas parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, çfarë nënkupton se brenda kësaj periudhe kohore (menjëherë pas përfundimit të vlerësimit, por jo më vonë se 7 ditë) autoriteti kontraktor duhet të komunikojë me ofertuesin për dorëzimin e dokumentacionit dhe vlerësimin e tij me qëllim që nëse përmbushen kushtet të vijohet me publikimin e njoftimit të

fituesit. Në këtë kuptim operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet që maksimalisht brenda 7 ditësh nga momenti i përfundimit të vlerësimit të ofertave të dorëzojë në autoritet kontraktor dokumentacionin e kërkuar dhe mbi bazën e vlerësimit të kryer nëse plotësohen kushtet autoriteti të procedojë me hapa të mëtejshëm procedurale siç është publikimi i njoftimit të fituesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuar), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: *“në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*. Ndërkohë nga ana e autoritetit kontraktor rezultoi e provuar, se dokumentacioni është dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes me datë 25.11.2025 me nr. prot. 10542 dhe ku në fletën e inventarit si dhe në dokumentacionin inventarizuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me anë të procesverbalit nr. 3 datë 25.11.2025, në të cilin konstatohet se, për mjetet “Rrul kompresor me vibrim” dhe “Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m<sup>3</sup>”, nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse ) për të provuar se këto mjete disponohen dhe janë në pronësi të operatorit ekonomik “Shendelli” Shpk.

Referuar të gjithë arsyetimit më lart KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimes pas kualifikimit si i pari, ka dështuar të provojë se ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për mjetet Rrul kompresor me vibrim dhe Eskavator me Zinxhir min. 0,25 m<sup>3</sup>, nuk është paraqitur asnjë dokument (kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse ) për të provuar se këto mjete disponohen dhe janë në pronësi të operatorit ekonomik “Shendelli” Shpk, brenda afatit me qëllim që autoriteti kontraktor të vazhdonte me hapat e mëtejshëm proceduralë sipas parashikimeve ligjore.

Sa më lart pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur- Pune Publike”, me Nr. REF-66960-10-28-2025, me

objekt: “Sistemimi i sheshit dhe tregut të fruta-perimeve në lagjen “Skënder Libohova”,Rruga Pavarësia”, me fond limit: *15 310 675.13 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e dhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë presje trembëdhjetë)* lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 14.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

